



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-03/01-9220/23 më

08. 05. 2023

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë

V E N D I M

1. MIRATOHET Ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit për organizimin, kompetencat, përgjegjësitë dhe sistematizimin e vendeve të punës së administratës komunale nr. 01-031-13761 i dt. 19.01.2016.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, ndryshimi dhe plotësimi nënkupton themelimin e Sektorit për Politika dhe Menaxhim, i cili do të funksionoj në kuadër të Drejtorisë së Mirëqenies Sociale.
3. Sipas pikës 2 të këtij Vendimi, Sektori për Politika dhe Menaxhim ka detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara si në vijim:
  - Harton politika për grupet e cenueshme;
  - Harton buxhetin në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi;
  - Ofron shërbime sociale dhe përkujdesje për rastet sociale të popullatës, brenda territorit të komunës;
  - Mbledhë dhe analizon informata dhe hulumtime në fushën sociale në nivel lokal;
  - Koordinon punën me Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa përkujdesje familjare, Shtëpinë për mbrojtjen e fëmijëve dhe mekanizmave të tjerë relevantë;
  - Harton strategji dhe plane të veprimit në përputhje me politikat sociale;
  - Përgatit planet vjetore për zhvillimin dhe avancimin e shërbimeve sociale dhe familjare;
  - Ndërmerr veprime për të siguruar fonde të mjaftueshme për ngritjen e vazhdueshme profesionale për profesionistët social;
  - Harton politika, programe dhe qasje për familjet dhe individët në situata të pafavorshme socio-ekonomike;

- Bashkëpunon me partnerët lokal dhe ndërkombëtarë për forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve socio - familjare;
- Bashkëpunon me ministrinë e linjës në sigurimin, distribuimin dhe ruajtjen e statistikave, informatave dhe konfidencialitetit të familjeve që marrin shërbime socio - familjare, sipas legjislacionit në fuqi;
- Kryen edhe punë të tjera, në përputhje me ligjet e aplikueshme në kuadër të fushë veprimtarisë së Drejtorisë.

4. Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit për organizimin, kompetencat, përgjegjësitë dhe sistematizimin e vendeve të punës së administratës komunale nr. 01-031-13761 i dt. 19.01.2016.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen të gjitha dispozitat e Vendimit nr. 01-031-13761 i dt. 19.01.2016 që bien në kundërshtim me këtë Vendim.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

**U DORËZOHET:**

- Drejtorisë së Mirëqenies Sociale;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**

**Përparim Rama**

